

Direktiva 2000/76/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 4 dhjetor 2000, mbi djegien e mbetjeve

Gazeta Zyrtare L 332, 28/12/2000 fq. 0091 – 0111

Direktiva 2000/76/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit datë 4 dhjetor 2000, mbi djegien e mbetjeve

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian, dhe në veçanti nenin 175 pika 1 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve [3],

Duke vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 251 të Traktatit [4], dhe sipas tekstit të përbashkët të miratuar nga Komiteti i Pajtimit, më 11 tetor 2000,

Duke pasur parasysh se:

(1) Programi i Pestë i Veprimit Mjedisor: në lidhje me qëndrueshmërinë – një program i Komunitetit Europian për politikën dhe veprimin, në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të plotësuar nga Vendimi nr. 2179/98/KE në rishikimin e tij [5], cakton si objektiv që ngarkesat kritike dhe nivelet e disa ndotësve të tillë, si oksidet e azotit (No_x), dioksidet e squfurit (SO_2), metalet e rënda dhe dioksinat nuk duhet të tejkalohen për impiantet që djegin më shumë se 3 ton mbetje të ngurta urbane në orë, ndërsa për sa i përket cilësisë së ajrit, objektivi është që të gjithë njerëzit duhet të jenë të mbrojtur me efektshmëri nga rreziqet e njohura për shëndetin e tyre, të shkaktuara nga ndotja e ajrit. Ai program, më tej cakton si objektiv pakësimin në masën 90% të shkarkimeve të dioksinave të burimeve të identifikuara deri në vitin 2005 (niveli i vitit 1985), dhe të paktën pakësimin në masën 70% nga të gjitha rrugët e shkarkimeve të kadmiumit (Cd), merkurit (Hg) dhe plumbit (Pb) në vitin 1995.

(2) Protokolle për ndotësit e qëndrueshëm organikë, i nënshkruar nga Komuniteti në kuadrin e Konventës së Komisionit Ekonomik për Europën, të Kombeve të Bashkuara (UN-EKE), për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, cakton vlerat kufi ligjërish të detyrueshme për shkarkimet e dioksinave dhe furaneve prej 0,1 ng/m; TE-të (Të barasvlefshmet Toksike) për impiantet që djegin më shumë se 3 ton mbetjesh të ngurta urbane në orë, 0,5 ng/m; TE-të për impiantet që djegin më shumë se 1 ton mbetjesh mjekësore në orë, dhe 0,2 ng/m; për impiantet që djegin më shumë se 1 ton mbetjesh të rrezikshme në orë.

(3) Protokolle për Metalet e Rënda, i nënshkruar nga Komuniteti në kuadrin e Konventës së UN-EKE-së për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, cakton vlerat kufi ligjërish të detyrueshme për shkarkimet e grimcave prej 10 mg/m³ për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe mjekësore, si edhe për shkarkimin e merkurit prej 0,05 mg/m³ për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe 0,08 mg/m³ për djegien e mbetjeve urbane.

(4) Agjensia Ndërkombëtare e Kërkimit për Kancerin dhe Organizata Botërore e Shëndetit tregojnë që disa hidrokarbure aromatike policiklike (PAHs) janë kancerogjene. Prandaj, Shtetet Anëtare mund të caktojnë edhe vlerat kufi për PAHs-në ndërmjet ndotësve të tjerë.

(5) Në përputhje me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, ashtu siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit, ekziston nevoja për të vepruar në rang Komuniteti. Parimi paraprak parashikon bazën për masat e mëtejshme. Kjo direktivë kufizohet tek kërkesat minimale për impiantet e djegies dhe bashkëdjegies.

- (6) Më tej, neni 174 parashikon që politika e Komunitetit për mjedisin është që të kontribuohet në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.
- (7) Prandaj një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut kërkon përcaktimin dhe mbajtjen e kushteve rigorozë operacionale, kërkesave teknike dhe vlerave kufi të shkarkimeve për impiantet që djegin apo bashkëdjegin mbetje brenda Komunitetit. Vlerat kufi të vendosura duhet të parandalojnë apo kufizojnë sa më shumë të jetë e mundur efektet negative mbi mjedisin, si edhe rreziqet që rezultojnë për shëndetin e njeriut.
- (8) Komunikata e Komisionit për shqyrtimin e Strategjisë së Komunitetit për administrimin e mbetjeve, përcakton parandalimin e mbetjeve si prioritet të parë, të ndjekur nga ripërdorimi dhe rekuperimi dhe në fund nga asgjësimi i sigurt i mbetjeve; në Rezolutën e tij, të datës 24 shkurt 1997, në lidhje me Strategjinë e Komunitetit për administrimin e mbetjeve [6], Këshilli e përsëriti bindjen e tij se parandalimi i mbetjeve do të ishte prioriteti i parë i çdo politike racionale për mbetjet në lidhje me minimizimin e prodhimit të mbetjeve dhe karakteristikave të rrezikshme të tyre.
- (9) Në Rezolutën e tij, të datës 24 shkurt 1997, Këshilli gjithashtu nënvizon rëndësinë e kriterëve të Komunitetit në lidhje me përdorimin e mbetjeve, nevojën për zbatimin e standardeve të përshtatshme të shkarkimit në impiantet e djegies, nevojën për masat vëzhguese që duhet të parashikohen për impiantet ekzistuese të djegies, si edhe nevojën që Komisioni të shqyrtojë ndryshimin e legjislacionit të Komunitetit në lidhje me djegien e mbetjeve me rikuperim të energjisë, me qëllim mënjanimin e lëvizjeve të mbetjeve në shkallë të madhe për djegien dhe bashkëdjegien të tyre në Komunitet.
- (10) Është e nevojshme të vendosen rregulla të rrepta për të gjitha impiantet që djegin dhe bashkëdjegin mbetje, me qëllim mënjanimin e lëvizjeve ndërkufitare të impianteve që punojnë më kosto të ulët në sajë të standardeve mjedisore më pak rigorozë.
- (11) Komunikata nga Komisioni energjia për të ardhmen: burimet e ripërtëritshme të energjisë/ letra e bardhë (*carta bianca*) për një strategji të Komunitetit dhe plani i veprimit marrin parasysh në veçanti përdorimin e biomasës për qëllime energjetike.
- (12) Direktiva e Këshillit 96/61/KE [7] parashikon një qasje të integruar ndaj parandalimit të ndotjes dhe kontrollit, në të cilën të gjitha aspektet e performancës mjedisore të impianteve shqyrtohen në një mënyrë të integruar. Impiantet për djegien e mbetjeve urbane me një kapacitet që i tejkalon 3 ton në orë dhe impiantet për asgjësimin apo rikuperimin e mbetjeve të rrezikshme me një kapacitet që i tejkalon 10 ton në ditë janë përfshirë brenda fushës së zbatimit të direktivës në fjalë.
- (13) Respektimi i vlerave kufi të shkarkimeve të caktuara nga kjo direktivë duhet të konsiderohet si e nevojshme, por jo si një kusht i mjaftueshëm për plotësimin e kërkesave të Direktivës 96/61/KE. Kjo përbushje mund të përfshijë vlera kufi më rigorozë të shkarkimeve të ndotësve të parashikuar në këtë direktivë, vlerat kufi të shkarkimeve për substanca të tjera dhe mjeteve të tjera, si edhe kushtet e tjera të përshtatshme.
- (14) Përvoja industriale në vënien në zbatim të teknikave për pakësimin e shkarkimeve ndotëse nga impiantet djegëse është përfituar gjatë një periudhe kohore dhjetë vjeçare.
- (15) Direktivat e Këshillit 89/369/KEE [8] dhe 89/429/KEE [9] për parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së ajrit nga impiantet e djegies së mbetjeve urbane kanë kontribuar në pakësimin dhe kontrollin e shkarkimeve në atmosferë nga impiantet e djegies. Duhet miratuar rregulla më shtrënguese në këtë drejtim dhe në këto rrethana, këto direktiva duhen shfuqizuar.
- (16) Dallimi ndërmjet mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme bazohet parimisht në karakteristikat e mbetjeve para djegies apo bashkëdjegies së tyre, por jo tek ndryshimet në shkarkime. Të njëjtat vlera kufi të shkarkimeve duhet të zbatohen për djegien dhe bashkëdjegien e mbetjeve si të rrezikshme, ashtu edhe jo të

rrezikshme, por duhet të mbahen teknika dhe kushte të ndryshme të djegies dhe bashkëdjegies si edhe të merren masa të ndryshme vëzhguese në momentin e pranimit të mbetjeve.

(17) Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh Direktivën e Këshillit 1999/30/KE, datë 22 prill 1999, në lidhje me vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidet e azotit, lëndën në formë grimcash dhe plumbin në ajrin e ambientit [10] kur të zbatojnë këtë direktivë.

(18) Djegia e mbetjeve të rrezikshme me një përmbajtje më të lartë se 1% e substancave organike halogjene, të shprehura si klor, duhet të plotësojë disa kushte operationale, me qëllim asgjësimin e sa më shumë ndotësve organikë të tilla si dioksina që të jetë e mundur.

(19) Djegia e mbetjeve që përmbajnë klor prodhon mbetje të gazeve të oxhakut. Këto mbetje duhet të administrohen në mënyrë të tillë që të pakësohet sasia dhe rrezikshmëria e tyre.

(20) Mund të ekzistojnë arsye për parashikimin e përjashtimeve të përcaktuara nga vlerat kufi të shkarkimeve për disa ndotës gjatë një periudhe të caktuar dhe që i nënshtrohen kushteve të caktuara.

(21) Kriteret për disa fraksione të klasifikuara të ndezshme të mbetjeve jo të rrezikshme të cilat nuk janë të përshtatshme për riciklim, duhet të zhvillohen me qëllim që të lejohet autorizimi i pakësimit të frekuencës së matjeve të rregullta.

(22) Një tekst i vetëm për djegien e mbetjeve do të përmirësojë qartësinë dhe zbatueshmërinë ligjore. Duhet të ekzistojë vetëm një direktivë për djegien dhe bashkëdjegien e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme duke pasur parasysh përmbajtjen dhe strukturën e Direktivës së Këshillit 94/67/KE, datë 16 dhjetor 1994, për djegien e mbetjeve të rrezikshme [11]. Prandaj Direktiva 94/67/KE duhet që gjithashtu të shfuqizohet.

(23) Neni 4 i Direktivës së Këshillit 75/442/KEE, datë 15 korrik 1975, për mbetjet [12] kërkon nga Shtetet Anëtare që të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mbetjet të rikuperohen apo asgjësohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin. Për këtë qëllim, nenet 9 dhe 10 të asaj direktive parashikojnë që çdo impiant apo sipërmarrje që merret me trajtimin e mbetjeve duhet të sigurojë një leje nga autoritetet kompetente duke iu referuar, ndërmjet të tjerave, edhe masave paraprake që duhen marrë.

(24) Kërkesat për rikuperimin e nxehtësisë së prodhuar nga procesi i djegies apo bashkëdjegies, si edhe ato për minimizimin dhe riciklimin e mbetjeve që rezultojnë nga puna e impianteve të djegies dhe bashkëdjegies do të ndihmojnë në përmbushjen e objektivave të nenit 3 për hierarkinë e mbetjeve të Direktivës 75/442/KEE.

(25) Impiantet e djegies dhe bashkëdjegies që trajtojnë vetëm mbetje me origjinë shtazore që rregullohen nga Direktiva 90/667/KEE [13] përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Komisioni ka për synim të propozojë një rishikim të kërkesave të Direktivës 90/667 duke pasur parasysh sigurimin e standardeve më të larta mjedisore për djegien dhe bashkëdjegien e mbetjeve me origjinë shtazore.

(26) Leja për ngritjen e një impianti për djegien apo bashkëdjegien e mbetjeve gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në Direktivat 91/271/KEE [14], 96/61/KE, 96/62/KE [15], 76/464/KEE [16], dhe 1999/31/KE [17].

(27) Bashkëdjegia e mbetjeve, në impiante të cilat nuk kanë si synim kryesor djegien e mbetjeve, nuk duhet lejuar që të shkarkojë shkarkime më të larta të substancave ndotëse në atë pjesë të vëllimit të gazeve të shkarkuara që rezulton nga bashkëdjegia, sesa ato që lejohen për impiantet që merren me djegien e mbetjeve dhe si pasojë duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të duhura.

(28) Për të siguruar respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve të ndotësve, kërkohen teknika matjeje të një standardi të lartë të cilat do të vëzhgojnë këto shkarkime.

(29) Përfshirja e vlerave kufi të shkarkimeve për shkarkimet e ujërave të ndotura nga pastrimi i gazeve të shkarkuara nga impiantet e djegies dhe bashkëdjegies do të kufizojë transferimin e ndotësve nga ajri në ujë.

(30) Duhet përcaktuar dispozitat për rastet kur vlerat kufi të shkarkimeve janë tejkaluar si edhe në lidhje me ndalimet, shqetësimet apo defektet teknikisht të pashmangshme të makinerive të pastrimit apo të matjes.

(31) Me qëllim që të sigurohet transparenca e procesit të dhënies së lejeve në të gjithë Komunitetin, publiku duhet të ketë të drejtën për t'u njohur me synimin e lejimit të tij për t'u përfshirë në vendimet që do të merren pas paraqitjes së kërkesave për lejet e reja dhe përditësimet e tyre të mëpasshme. Publiku duhet të ketë të drejtën për t'u njohur me raportet mbi funksionimin dhe vëzhgimin e impianteve që djegin më shumë se 3 ton mbetje në orë, me qëllim që të informohet për efektet e tyre të mundshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

(32) Komisioni duhet t'i paraqesë një raport si Parlamentit European ashtu edhe Këshillit duke u mbështetur në përvojën e zbatimit të kësaj direktive, njohuritë e reja shkencore të fituara, zhvillimin e gjendjes së teknologjisë, progresin e arritur në teknikat e kontrollit të shkarkimeve, si edhe në përvojën e fituar në administrimin e mbetjeve, dhe punën e impianteve dhe në zhvillimin e kërkesave mjedisore, për të propozuar, ashtu si duhet, përshtatjen e dispozitave përkatëse të kësaj direktive.

(33) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, të datës 28 qershor 1999, ku përcaktohen procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i jepen Komisionit [18].

(34) Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë rregullat për sanksionet ndaj shkeljeve të dispozitave të kësaj direktive dhe të sigurojnë që ato të zbatohen: këto sanksione duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe parandaluese,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj direktive është të parandalojë apo të kufizojë sa më shumë të jetë e mundur efektet negative në mjedis, në veçanti ndotjen e shkaktuar nga shkarkimet në ajër, tokë, ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, si edhe rreqizet që rezultojnë për shëndetin e njeriut, nga djegia dhe bashkëdjegia e mbetjeve.

Ky qëllim do të përmbushet me anë të kushteve shtrënguese të punës si edhe kërkesave teknike, nëpërmjet caktimit të vlerave kufi të shkarkimit për impiantet e djegies dhe bashkëdjegies së mbetjeve brenda Komunitetit, dhe gjithashtu edhe nëpërmjet plotësimit të kërkesave të Direktivës 75/442/ KEE.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë mbulon impiantet e djegies dhe bashkëdjegies.
2. Sidoqoftë, impiantet e mëposhtme do të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive:
 - (a) Impiantet që trajtojnë vetëm mbetjet e mëposhtme:
 - (i) mbetjet e perimeve nga bujqësia dhe pyjet,
 - (ii) mbetjet e perimeve nga industria e përpunimit ushqimor, nëse nxehtësia e prodhuar mund të rikuperohet,
 - (iii) mbetjet me fibra të perimeve nga prodhimi i brumit të paprekur si edhe nga prodhimi i letres nga brumi, nëse ai mund të bashkëdigjet në vendin e prodhimit dhe nxehtësia e prodhuar të mund të rikuperohet,
 - (iv) mbetjet drusore me përjashtim të atyre të cilat mund të përmbajnë përbërje organike halogjene apo metale të rënda si rezultat i trajtimit me veshje drusore, dhe që përfshin në veçanti të tilla mbetje drusore të cilat e kanë origjinën nga mbetjet e ndërtimit dhe prishjes,
 - (v) mbetjet e tapave,
 - (vi) mbetjet radioaktive,
 - (vii) kufomat e kafshëve ashtu siç rregullohet nga Direktiva 90/667/KEE pa cenuar ndryshimet në të ardhmen,

(viii) mbetjet që rezultojnë nga kërkimi për, dhe nga shfrytëzimi i burimeve të naftës dhe gazit nga impiantet detare dhe që digjen në bordin e këtyre impianteve;

(b) Impiantet eksperimentale të përdorura për kërkim, zhvillim dhe testim me qëllim përmirësimin e procesit të djegies dhe të cilat trajtojnë më pak se 50 ton mbetje në vit.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj direktive:

1. “mbetje” nënkupton të gjitha mbetjet e lëngshme apo të ngurta ashtu siç përkufizohen në nenin 1 germa (a) të Direktivës 75/442/KEE;

2. “mbetje të rrezikshme” nënkupton të gjitha mbetjet e lëngshme apo të ngurta ashtu siç përkufizohen në nenin 1 pika 4 të Direktivës së Këshillit 91/689/KEE, datë 12 dhjetor 1991, për mbetjet e rrezikshme [19]. Për mbetjet e rrezikshme të mëposhtme, kërkesat e caktuara për mbetjet e rrezikshme në këtë direktivë nuk do të zbatohen:

(a) mbetjet e lëngshme të djegshme duke përfshirë vajrat e mbetura ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës së Këshillit 75/439/KEE datë 16 qershor 1975, për asgjësimin e vajrave të mbetura, [20] me kusht që ato të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

(i) përmbajtja e masës së hidrokarbureve aromatike të poliklorinuara, p.sh. bifenilet e poliklorureve (PCB) apo fenoli i pentaklorurit arrin në përqendrim jo më të larta se ato që parashikohen në legjislacionin përkatës të Komunitetit;

(ii) këto mbetje nuk bëhen të rrezikshme në sajë të faktit që ato përmbajnë përbërës të tjerë të renditur në Shtojcën II të Direktivës 91/689/KEE në sasi të apo përqendrime të cilat janë të papajtueshme me arritjen e objektivave të caktuara në nenin 4 të Direktivës 75/442/KEE; dhe

(iii) vlera neto kalorifike arrin në të paktën 30 MJ për kg.

(b) të gjitha mbetjet e lëngshme të djegshme të cilat nuk mund të shkaktojnë, në gazet e oxhakut që rezultojnë drejtpërdrejt nga djegia e tyre, shkarkime të tjera përveç atyre nga gazoili, ashtu siç parashikohet në nenin 1 pika 1 të Direktivës 93/12/KEE [21], ose një përqendrim më të lartë të shkarkimeve sesa të atyre që rezultojnë nga djegia e gazoilit siç përcaktohet;

3. “mbetje urbane të përziera” nënkupton mbetjet me origjinë familjare si edhe mbetjet tregtare, industriale dhe institucionale, të cilat për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre janë të ngjashme me mbetjet me origjinë familjare, por duke përjashtuar fraksionet e treguara në shtojcën e Vendimit 94/3/KE [22] nëntitullin 20 01 të cilat grumbullohen veçmas në burim, dhe duke përjashtuar mbetjet e tjera që paraqiten në titullin 20 02 të po asaj shtojce;

4. “impiant djegieje” nënkupton çdo njësi dhe pajisje e palëvizshme apo e lëvizshme që merret me trajtimin termik të mbetjeve me ose pa rikuperim të nxehtësisë së prodhuar gjatë djegies. Kjo përfshin djegien nëpërmjet oksidimit të mbetjeve si edhe procese të tjera trajtimi termik, të tilla si piroliza, gazifikimi apo proceset e plazmës, për sa kohë që substancat që rezultojnë nga trajtimi të digjen menjëherë më pas.

Ky përkufizim mbulon trullin dhe të gjithë impiantin e djegies duke përfshirë të gjitha linjat e djegies, pritjen e mbetjeve, ruajtjen, mjediset e paratrajtimin në terren, sistemet e furnizimit me ujë dhe lëndët djegëse të mbetjeve, kaldajën, pajisjet për trajtimin e gazeve të shkarkuara, mjediset në terren për trajtimin apo ruajtjen e mbetjeve dhe ujërave të ndotura, oxhakët, pajisjet dhe sistemet për kontrollin e punëve të djegies, regjistrimin dhe vëzhgimin e kushteve të djegies;

5. “impiant bashkëdjegieje” nënkupton çdo impiant i palëvizshëm apo i lëvizshëm, qëllimi kryesor i të cilit është prodhimi i energjisë apo i produkteve materiale, dhe i cili i përdor mbetjet si lëndë djegëse të rregullta apo shtesë, dhe në të cilin mbetjet trajtohen termikisht për qëllimin e asgjësimit të tyre.

Nëse bashkëdjegia ndodh në mënyrë të tillë që qëllimi kryesor i impiantit të mos jetë prodhimi i energjisë apo produkteve të materialeve, por trajtimi termik i mbetjeve, atëherë ky impiant do të konsiderohet si impiant djegieje brenda kuptimit të pikës 4. Përkufizimi mbulon truallin dhe të gjithë impiantin duke përfshirë të gjitha linjat e djegies, pritjen e mbetjeve, ruajtjen, objektet e paratrajtit në terren, sistemet e furnizimit me ajër, lëndë djegëse dhe mbetje, kaldajën, pajisjet për trajtimin e gazeve të shkarkuara, pajisjet në terren për trajtimin apo ruajtjen e mbetjeve dhe ujërave të ndotura, oxhakët, pajisjet dhe sistemet për kontrollin e punës së djegies, regjistrimin dhe vëzhgimin e kushteve të djegies;

6. “impiant ekzistues djegieje apo bashkëdjegieje” nënkupton një impiant djegieje apo bashkëdjegieje:
 - (a) i cili është vënë në punë dhe ka një leje në përputhje me legjislacionin ekzistues të Komunitetit para datës 28 dhjetor 2002, ose,
 - (b) i cili është i autorizuar apo regjistruar për djegie apo bashkëdjegie dhe ka një leje të të lëshuar para datës 28 dhjetor 2002, në përputhje me legjislacionin ekzistues të Komunitetit, me kusht që impianti të ketë filluar punën jo më vonë se data 28 dhjetor 2003, ose
 - (c) i cili, në pikëpamjen e autoritetit kompetent, është objekt i një kërkesë të plotë për leje, para datës 28 dhjetor 2002, me kusht që impianti të jetë vënë në punë jo më vonë se data 28 dhjetor 2004;
7. “kapaciteti nominal” nënkupton shumën e kapaciteteve të djegies së furrave prej të cilave përbëhet impianti, ashtu siç përcaktohet nga ndërtuesi dhe konfirmohet nga përdoruesi, duke marrë parasysh ashtu siç duhet, në veçanti, vlerën kalorifike të mbetjeve, të shprehur në sasinë e mbetjeve të djegura në orë;
8. “shkarkimi” nënkupton shkarkimin e drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të substancave, vibracioneve, nxehtësisë apo zhurmës nga burime fikse individuale apo të shpërndara nga impianti në ajër, ujë apo tokë;
9. “vlerat kufi të shkarkimeve” nënkupton masa, të shprehura në termat e disa parametrave të caktuara, përqendrimi dhe/ose niveli i një shkarkimi, të cilët nuk mund të tejkalohen gjatë një ose më shumë periudhave kohore;
10. “dioksinat dhe furanet” nënkupton të gjitha dioksinat dibenzo-p-të poliklorinuara si edhe dibenzofuranet e renditura në Shtojcën I;
11. “përdoruesi” nënkupton çdo person fizik apo juridik i cili punon me apo e kontrollon impiantin, ose, në rast se parashikohet nga legjislacioni kombëtar, ai të cilit i është ngarkuar pushteti ekonomik vendimtar mbi funksionimin teknik të impiantit;
12. “leja” nënkupton një vendim të shkruar (ose disa vendime të tilla) të lëshuar nga autoriteti kompetent të cilat japin autorizimin për të vënë në punë një impiant, që është objekt i kushteve të caktuara të cilat garantojnë që impianti në fjalë përmbush të gjitha kërkesat e direktivës. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë impiante apo pjesë impiantesh në të njëjtën vendndodhje që shfrytëzohet nga i njëjti operator;
14. “mbetje” nënkupton çdo material të lëngshëm apo të ngurtë (duke përfshirë edhe hirin që ngelet në fund dhe skorjet, hirin fluturues dhe pluhurin e kaldajës, produktet e ngurta të reaksioneve nga trajtimi i gazeve, llumrat e kanalizimeve nga trajtimi i ujërave të zeza, katalizatorët e konsumuar dhe karboni i aktivizuar i konsumuar) të përkufizuara si mbetje në nenin 1 germa a të Direktivës 75/442/KEE, të cilat prodhohen nga proceset e djegies dhe bashkëdjegies, të trajtimit të gazeve të shkarkuara apo ujërave të zeza, si edhe nga procese të tjera brenda impiantit të djegies apo të bashkëdjegies.

Neni 4

Kërkesa dhe leja

1. Pa cenuar nenin 11 të Direktivës 75/442/KEE apo nenin 3 të Direktivës 91/689/KEE, asnjë impiant djegieje apo bashkëdjegieje nuk do të veprojë pa pasur leje për të kryer këto veprimtari.

2. Pa cenuar Direktivën 96/61/KE,, kërkesa për leje për një impiant djegieje apo bashkëdjegieje tek një autoritet kompetent duhet të përfshijë një përshkrim të masave të cilat janë parshikuar për të garantuar që:

- (a) impianti të jetë projektuar, pajisur dhe do të operohet në mënyrë të tillë që kërkesat e kësaj direktive të marrin parasysh kategoritë e mbetjeve që do të digjen;
- (b) nxehtësia e prodhuar gjatë procesit të djegies dhe bashkëdjegies të rikuperohet sa më shumë të jetë e mundur p.sh. nëpërmjet nxehtësisë dhe fuqisë së kombinuar, prodhimit të avullit të procesit apo ngrohjes së rajonit;
- (c) mbetjet do të minimizohen në sasinë dhe rrezikshmërinë e tyre dhe do të riciklohen atje ku është me vend;
- (d) asgjësimi i mbetjeve të cilat nuk mund të parandalohen, pakësohen apo riciklohen do të kryhet në pajtim me legjislacionin e Komunitetit dhe atë kombëtar.

3. Leja do të jepet vetëm në rast se kërkesa tregon që teknikat e propozuara të matjes për shkarkimet në ajër përmbushin kërkesat e Shtojcës III, dhe përsa i përket ujit, ato të Shtojcës III, paragrafët 1 dhe 2.

4. Leja e dhënë nga autoriteti kompetent për një impiant djegieje apo bashkëdjegieje duhet që, përveç përmbushjes së çdo kërkesë të zbatueshme në Direktivat 91/271/KEE, 96/61/KE, 96/62/KE, 76/464/KEE dhe 1999/31/KE:

- (a) të rendisë qartësisht kategoritë e mbetjeve që mund të trajtohen. Lista duhet të përdorë të paktën kategoritë e mbetjeve të përcaktuara në Katalogun Europian të Mbetjeve (EWC), nëse është e mundur, si edhe të përmbajë informacionin e duhur në lidhje me sasinë e mbetjeve, atje ku është e përshtatshme;
- (b) të përfshijë kapacitetin total të impiantit të djegies apo bashkëdjegies së mbetjeve;
- (c) të përcaktojë procedurat e marrjes së kampionëve dhe të matjes që përdoren për të përmbushur detyrimet e vendosura për matjet periodike të çdo ndotësi të ajrit dhe ujit.

5. Leja që i jepet një impianti të djegies apo bashkëdjegies që përdor mbetje të rrezikshme nga autoriteti kompetent përveç paragrafit 4, duhet që :

- (a) të rendisë sasinë e kategorive të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme që mund të trajtohen;
- (b) të përcaktojë rrjedhat maksimale dhe minimale të masës së atyre mbetjeve të rrezikshme, vlerat e tyre maksimale dhe minimale kalorifike si edhe përmbajtjen e tyre maksimale të ndotësve, p.sh. PCB, PCP, klorit, fluorit, squfurit, metaleve të rënda.

(6) Pa cenuar dispozitat e Traktatit, Shtetet Anëtare mund të rendisin kategoritë e mbetjeve që do të përfshihen në leje të cilat mund të bashkëdigjen në kategoritë e caktuara të impianteve të bashkëdjegies.

(7) Pa cenuar Direktivën 96/61/KE, autoriteti kompetent duhet të rishqyrtojë në mënyrë periodike, dhe atje ku është e përshtatshme, të përditësojë kushtet e lejes.

(8) Në rast se operatori i një impianti për djegien dhe bashkëdjegien e mbetjeve jo të rrezikshme parashikon një ndryshim të veprimit që do të përfshijë djegien apo bashkëdjegien e mbetjeve të rrezikshme, ky duhet të konsiderohet si një ndryshim thelbësor në bazë të kuptimit të nenit 2 pika 10 germa (b) të Direktivës 96/61/KE, dhe në këtë rast do të zbatohet neni 12 pika 2 i asaj direktive.

(9) Nëse një impiant i djegies apo bashkëdjegies nuk përmbush kushtet e lejes, në veçanti ato që kanë të bëjnë me vlerat kufi të shkarkimeve për ajrin dhe ujin, autoriteti kompetent duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të zbatuar përmbushjen e tyre.

Neni 5

Dërgimi dhe marrja në dorëzim e mbetjeve

1. Operatori i impiantit të djegies apo bashkëdjegies duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake, në lidhje me dërgimin dhe marrjen në dorëzim të mbetjeve, me qëllim parandalimin apo kufizimin sa më shumë

të jetë e mundur të efekteve negative mbi mjedisin, në veçanti ndotjen e ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore, si edhe aromat dhe zhurmën, dhe rreziqet e drejtpërdrejta ndaj shëndetit të njeriut. Këto masa duhet që të paktën të plotësojnë kërkesat e parashikuara në paragrafët 3 dhe 4.

2. Operatori duhet të përcaktojë masën e çdo kategorie të mbetjeve, nëse është e mundur sipas EWC-së, para pranimit të mbetjeve në impiantin e djegies apo të bashkëdjegies.

3. Para pranimit të mbetjeve në impiantin e djegies apo të bashkëdjegies, operatori duhet të ketë informacionin e disponueshëm në lidhje me mbetjet për qëllimin e verifikimit, ndër të tjerave, edhe të përmbushjes së kërkesave të lejes të përcaktuara në nenin 4 pika 5. Ky informacion duhet të përfshijë:

(a) të gjithë informacionin administrativ për procesin e prodhimit në dokumentet e përmendura në paragrafin 4(a);

(b) përbërjen fizike, dhe sa më shumë të jetë e mundur atë kimike të mbetjeve, si edhe të gjitha informacionet e tjera të nevojshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për procesin e synuar të djegies;

(c) karakteristikat e rrezikshme të mbetjeve, substancat me të cilat ato nuk mund të përzihen, si edhe masat paraprake që duhen marrë gjatë trajtimit të mbetjeve.

4. Para pranimit të mbetjeve në impiantin e djegies apo bashkëdjegies, të paktën procedurat e mëposhtme të marrjes në dorëzim duhet që të ndiqen nga operatori:

(a) kontrolli i dokumenteve që kërkohen nga Direktiva 91/689/KEE dhe, atje ku është e zbatueshme, i atyre që kërkohen nga Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 259/93 datë 1 shkurt 1993, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e dërgesave të mbetjeve brenda, në drejtim të dhe nga Komuniteti Europian [23] si edhe nga rregulloret për transportin e mallrave të rrezikshme;

(c) marrja e kampionëve përfaqësues, në rast se diçka e tillë është e përshtatshme, p.sh. për mbetjet klinike infektuese, sa më shumë të jetë e mundur para shkarkimit të tyre, për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me informacionin e parashikuar në paragrafin 3 duke ushtruar kontrole, dhe për të bërë të mundur që autoritetet kompetente të identifikojnë natyrën e mbetjeve që do të trajtohen. Këto kampionë duhet të ruhen për të paktën një muaj pas djegies.

5. Autoritetet kompetente mund të lejojnë përjashtime nga paragrafët 2,3 dhe 4 për impiantet industriale dhe ndërmarrjet që djegin apo bashkëdjegin mbetjet e veta në vendin e prodhimit të mbetjeve, me kusht që të përmbushen kërkesat e kësaj direktive.

Neni 6

Kushtet e punës

1. Impiantet e djegies duhet të operohen me qëllim që të arrihet një nivel i tillë djegieje që përmbajtja e Karbonit Organik Total (TOC) e hirit dhe skorjeve që mbeten në fund të jetë më pak se 3%, ose që humbja e tyre gjatë djegies të jetë më pak se 5% e peshës së thatë të materialit. Nëse është e nevojshme, duhet të përdoren teknikat e duhura të paratrajtit të mbetjeve.

Impiantet e djegies duhet të projektohen, pajisen dhe operohen në mënyrë të tillë që gazet që rezultojnë nga procesi të ngrihen, pas injektimit të fundit të ajrit të djegies, në një mënyrë të kontrolluar dhe të njëtrajtshme dhe madje edhe në kushtet më të pafavorshme deri në temperaturën 850°C, të matur afër murit të brendshëm apo një pike tjetër përfaqësuese të dhomës së djegies, ashtu siç autorizohet nga autoriteti kompetent, për dy sekonda. Nëse mbetjet e rrezikshme me një përmbajtje prej më shumë se 1% të substancave organike të halogjenuara, të shprehura si klor, digjen, temperatura duhet të ngrihet deri në 1 100°C për të paktën dy sekonda.

Çdo linjë e impiantit të djegies duhet të pajiset me të paktën një pajisje djegëse ndihmëse. Kjo pajisje djegëse duhet të ndizet automatikisht kur temperatura e gazeve të djegies pas injeksionit të fundit të ajrit të djegies bie poshtë 850°C ose 1 100°C sipas rastit. Ai duhet të përdoret gjithashtu edhe gjatë operacioneve të fillimit dhe të

mbylles, me qëllim që të sigurohet që temperaturat prej 850°C ose 1 100°C, sipas rastit, të ruhen gjatë gjithë kohës së këtyre operacioneve, për sa kohë që mbetjet e padjegura ndodhen në dhomën e djegies.

Gjatë operacioneve të fillimit dhe mbylles ose kur temperatura në dhomën e djegies bie poshtë 850°C ose 1 100°C sipas rastit, pajisja djegëse ndihmëse nuk duhet të ushqehet me lëndë djegëse të cilat mund të shkaktojnë shkarkime më të larta se sa ato që rezultojnë nga djegia e gazoilit siç parashikohet në nenin 1 pika 1 të Direktivës së Këshillit 75/716/KEE, gazeve të lëngëzuara apo gazit natyror.

2. Impiantet e bashkëdjegies duhet të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që gazet që rezultojnë nga procesi i bashkëdjegies së mbetjeve të ngrihen, në një mënyrë të kontrolluar dhe të njëtrajtshme dhe madje edhe në kushtet më të pafavorshme deri në temperaturën 850°C, të matur afër murit të brendshëm apo një pike tjetër përfaqësuese të dhomës së djegies, ashtu siç autorizohet nga autoriteti kompetent, për dy sekonda. Nëse mbetjet e rrezikshme me një përmbajtje prej më shumë se 1% të substancave organike të halogjenuara, të shprehura si klor, bashkëdigjen, temperatura duhet të ngrihet deri në 1 100°C për të paktën dy sekonda.

3. Impiantet e djegies dhe bashkëdjegies duhet të kenë dhe të vënë në punë një sistem automatik për të parandaluar furnizimin e mbetjeve:

- (a) gjatë fazës së fillimit, derisa të arrihet temperatura prej 850° C ose 1 100°C sipas rastit, ose temperatura e përcaktuar sipas paragrafit 4;
- (b) sa herë që temperatura 850°C ose 1 100°C sipas rastit, apo temperatura e përcaktuar sipas paragrafit 4 të mos ruhet;
- (c) sa herë që masat e vazhdueshme që kërkohen nga kjo direktivë të tregojnë që vlerat kufi të shkarkimit janë tejkaluar, për shkak të shqetësimeve apo defekteve të pajisjeve pastruese.

4. Kushtet e ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 2 dhe, përta i përket temperaturës, në paragrafin 3 dhe të përcaktuara në leje për disa kategori mbetjesh apo për procese të caktuara termike mund të autorizohen nga autoriteti kompetent, me kusht që të plotësohen kërkesat e kësaj direktive. Shtetet Anëtare mund të hartojnë rregulla për qeverisjen e këtyre autorizimeve. Ndryshimi i kushteve operacionale nuk duhet të shkaktojë më shumë mbetje, apo mbetje me një përmbajtje më të lartë të ndotësve organikë, në krahasim me mbetjet e pritshme në bazë të kushteve të parashikuara në paragrafin 1.

Kushtet e ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 2 dhe, përta i përket temperaturës, në paragrafin 3 dhe të përcaktuara në leje për disa kategori mbetjesh, apo për procese të caktuara termike, mund të autorizohen nga autoriteti kompetent, me kusht që të plotësohen kërkesat e kësaj direktive. Shtetet Anëtare mund të hartojnë rregulla për qeverisjen e këtyre autorizimeve. Një autorizim i tillë duhet të kushtëzohet të paktën në bazë të dispozitave për vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuar në Shtojcën V për karbonin organik total dhe CO të cilat i kanë përmbushur.

Në rastin e bashkëdjegies së mbetjeve të veta në vendin e prodhimit të tyre në kaldajat ekzistuese të industrisë së letrës dhe brumit të letrës, një autorizim i tillë duhet të kushtëzohet të paktën në bazë të dispozitave për vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën V për karbonin organik total të cilat i kanë përmbushur.

Të gjitha kushtet e operimit të parashikuara në këtë paragraf dhe rezultatet e verifikimeve të bëra duhet t'i komunikohen Komisionit nga Shtetet Anëtare si pjesë e informacionit të siguruar në përputhje me kërkesat për raportim.

5. Impiantet e djegies dhe bashkëdjegies duhet të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që të parandalohen shkarkimet në ajër, të cilat shkaktojnë ndotje të ndjeshme të ajrit në nivelin e sipërfaqes së tokës; në veçanti gazet e shkarkuara duhet të shkarkohen në një mënyrë të kontrolluar dhe në pajtim me standardet përkatëse të cilësisë së ajrit të Komunitetit nëpërmjet një oxhaku, lartësia e të cilit përlllogaritet në mënyrë të tillë që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.

6. Nxehtësia e çliruar gjatë procesit të djegies dhe bashkëdjegies duhet rikuperuar sa më shumë të jetë e mundur.

7. Mbetjet klinike infektuese duhet të dërgohen menjëherë në furrë, pa u përzier paraprakisht me kategori të tjera mbetjesh dhe pa u trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.
8. Administrimi i impiantit të djegies dhe bashkëdjegies duhet të lihet në duart e personit fizik i cili është kompetent për administrimin e këtij impiantit.

Neni 7

Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër

1. Impiantet e djegies duhet të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që të mos tejkalohen në gazet e shkarkuara vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën V.
 2. Impiantet e bashkëdjegies duhet të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që të mos tejkalohen në gazet e shkarkuara vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara sipas Shtojcës V.
- Nëse në një impiant të bashkëdjegies më shumë se 40% e nxehtësisë së çliruar vjen nga mbetjet e rrezikshme, atëherë do të zbatohen vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën V.
3. Rezultatet e matjeve të bëra për të verifikuar përmbushjen (respektimin) e vlerave kufi të shkarkimeve duhet të standardizohen në drejtim të kushteve të parashikuara në nenin 11.
 4. Në rastin e bashkëdjegies së mbetjeve urbane të përziera të patrajtuara, vlerat kufi do të caktohen në përputhje me Shtojcën V, dhe Shtojca II nuk do të zbatohet.
 5. Pa cenuar dispozitat e Traktatit, Shtetet Anëtare mund të caktojnë vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike ose për ndotës të tjerë.

Neni 8

Shkarkimi i ujërave nga pastrimi i gazeve të shkarkuara

1. Ujërat e ndotura që dalin nga pastrimi i gazeve të shkarkuara nga një impiant i djegies apo bashkëdjegies duhet të jenë objekt i lejes që jepet nga autoritetet kompetente.
2. Shkarkimet në mjedisin ujor të ujërave të ndotura që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të shkarkuara duhet të kufizohen sa më shumë të jetë e mundur, të paktën në përputhje me vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në Shtojcën IV.
3. Duke iu nënshtruar dispozitave të caktuara të lejes, ujërat e ndotura që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të shkarkuara mund të shkarkohen në mjedisin ujor pas trajtimit veçmas të tyre, me kusht që:
 - (a) të përmbushen kërkesat e Komunitetit përkatës, si edhe dispozitat kombëtare dhe lokale në formën e vlerave kufi të shkarkimeve; dhe
 - (b) përqendrimet e masës së substancave ndotëse të referuara ku në Shtojcën IV të mos tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara po aty.
4. Vlerat kufi të shkarkimeve duhet të zbatohen në pikën ku ujërat e ndotura që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të shkarkuara që përmbajnë substanca ndotëse të referuara në Shtojcën IV, janë shkarkuar nga impianti i djegies apo bashkëdjegies.

Atje ku ujërat e ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të shkarkuara, trajtohen në vend kolektivisht me burime të tjera të ujërave të ndotura në terren, operatori duhet të marrë masat e referuara në nenin 11:

- (a) për rrjedhën e ujërave të ndotura nga proceset e pastrimit të gazeve të shkarkuara, para futjes së tyre në impiantin mbledhës të trajtimit të ujërave të ndotura;

- (b) për rrjedhën apo rrjedhat e tjera të ujërave të ndotura, para futjes së saj apo të tyre në impiantin mbledhës të trajtimit të ujërave të ndotura;
- (c) në pikën e shkarkimit përfundimtar të ujërave të ndotura, pas trajtimit, nga impianti i djegies apo bashkëdjegies.

Operatori duhet të bëjë përlllogaritjet e duhura të bilancit teknologjik, me qëllim që të përcaktojë nivelet e shkarkimeve në derdhjen përfundimtare të ujërave të ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të djegies, të përcaktuara në Shtojcën IV, për rrjedhën e ujërave të ndotura nga procesi i pastrimit të shkarkimeve të gazta.

Në asnjë lloj rrethane nuk duhet të bëhet hollimi i ujërave të ndotura me qëllimin e përmbushjes (respektimit) të vlerave kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën IV.

5. Kur ujërat e ndotura nga pastrimi i gazeve të shkarkuara, që përmbajnë substancat ndotëse të referuara në Shtojcën IV, trajtohen jashtë impiantit të djegies apo bashkëdjegies në një impiant trajtimi që përdoret vetëm për trajtime të këtyre lloj ujërash të ndotura, vlerat kufi të shkarkimeve të Shtojcës IV duhet të zbatohen në pikën ku ujërat e ndotura largohen nga impianti i trajtimit. Nëse impianti i trajtimit, që ndodhet jashtë impiantit të djegies, nuk merret vetëm me trajtimin e ujërave të ndotura që rezultojnë nga djegia, operatori duhet të bëjë përlllogaritjet e duhura të bilancit teknologjik, siç parashikohet në paragrafin 4 germa (a), (b) dhe (c), me qëllim që të përcaktojë nivelet e shkarkimeve në derdhjen përfundimtare të ujërave të ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazeve të djegies, të përcaktuara në Shtojcën IV, për rrjedhën e ujërave të ndotura nga procesi i pastrimit të shkarkimeve të gazta.

Në asnjë lloj rrethane nuk duhet të bëhet hollimi i ujërave të ndotura me qëllimin e përmbushjes (respektimit) të vlerave kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën IV.

6. Në leje duhet:

- (a) të përcaktohen vlerat kufi të shkarkimit për substancat ndotëse të referuara në Shtojcën IV, në përputhje me paragrafin 2, dhe me qëllim plotësimin e kërkesave të referuara në paragrafin 3 germa (a);
- (b) të vendosen parametrat e kontrolleve operacionale për ujërat e ndotura të paktën për pH-in, temperaturën dhe rrjedhën.

7. Impiantet e djegies dhe bashkëdjegies, duke përfshirë edhe zonat e depozitimit të mbetjeve që i shoqërojnë, duhet të projektohen dhe operohen në mënyrë të tillë që të parandalohet shkarkimi i paautorizuar dhe aksidental i substancave ndotëse në tokë, ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin përkatës të Komunitetit. Për më tepër kapaciteti depozitues duhet të sigurohet për ujërat e ndotura të shiut që kanë rrjedhur nga impiantet e djegies apo bashkëdjegies, ose për ujërat e ndotura që rezultojnë nga operacionet e derdhjes apo të shuarjes së zjarreve.

Kapaciteti depozitues duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar që ujëra të tillë të mund të testohen dhe trajtohen para shkarkimit të tyre, atje ku është e nevojshme.

8. Pa cenuar asnjë paragjykim për dispozitat e Traktatit, Shtetet Anëtare duhet të caktojnë vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike, si edhe për ndotës të tjerë.

Neni 9 Mbetjet

Mbetjet që rezultojnë nga veprimi i impianteve të djegies dhe bashkëdjegies duhet të minimizohen në sasi dhe rrezikshmëri. Mbetjet duhet të riciklohen, atje ku është e përshtatshme, drejtpërdrejt në impiant apo jashtë tij, në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit.

Transportimi dhe depozitimi i menjëhershëm i mbetjeve të thata në formën e pluhurit, të tilla si pluhuri i kaldajës dhe mbetjet e thata nga trajtimi i gazeve të djegies, duhet të zhvillohen në mënyrë të tillë që të parandalohet shpërhapja në mjedis, p.sh. në kontenerë të mbyllur.

Para caktimit të rrugëve që do të ndiqen për asgjësimin apo riciklimin e mbetjeve nga impiantet e djegies dhe bashkëdjegies, duhet të kryhen testet e duhura për të përcaktuar karakteristikat fizike dhe kimike si edhe potencialin ndotës të mbetjeve të ndryshme të djegies. Analizat duhet të bëhen në lidhje me fraksionet totale të tretshme si edhe me fraksionet e tretshme të metaleve të rënda.

Neni 10 **Kontrolli dhe vëzhgimi**

1. Duhet të montohen pajisjet matëse dhe duhen përdorur teknikat e duhura me qëllim vëzhgimin e parametrave, kushteve dhe përqendrimeve të masës në lidhje me procesin e djegies dhe bashkëdjegies.
2. Në leje apo tek kushtet që i bashkëngjiten lejes së lëshuar nga autoriteti kompetent, duhet të përcaktohen kërkesat e matjeve.
3. Montimi dhe funksionimi i duhur i pajisjeve vëzhguese të automatizuara për shkarkimet në ajër dhe ujë duhet t'i nënshtrohet kontrollit dhe testit vjetor të mbikëqyrjes. Kalibrimi duhet kryer nëpërmjet matjeve paralele me metoda reference të paktën çdo tre vjet.
4. Vendndodhja e pikave të marrjes së kampionëve apo të matjeve duhet të caktohet nga autoritetet kompetente.
5. Matjet periodike të shkarkimeve në ajër dhe ujë duhet të kryhen në përputhje me Shtojcën III, pikat 1 dhe 2.

Neni 11 **Kërkesat e matjeve**

1. Shtetet Anëtare duhet, që ose nëpërmjet përcaktimit në kushtet e lejes ose me anë të rregullave të përgjithshme detyruese, të sigurojnë përmbushjen e paragrafëve 2 deri 12 dhe 17, për sa i përket ajrit, dhe paragrafëve 9 deri 14 dhe 17, që lidhen me ujërat.
2. Matjet e mëposhtme të ndotësve të ajrit duhet të kryhen në përputhje me Shtojcën III, në impiantet e djegies dhe bashkëdjegies:
 - matjet e vazhdueshme të substancave të mëposhtme: NO_x, me kusht që të caktohen vlerat kufi të shkarkimeve, CO, pluhuri total, TOC, HCl, HF, SO₂;
 - matjet e vazhdueshme të parametrave të mëposhtme të operacioneve të procesit: temperatura afër murit të brendshëm apo në një pikë tjetër përfaqësuese të dhomës së djegies siç autorizohet nga autoriteti kompetent, përqendrimi i oksigjenit, trysnia, temperatura dhe përbërja e avujve të ujit tek gazet e shkarkuara;
 - të paktën dy matje në vit për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet; të paktën një matje çdo tre muaj sidoqoftë duhet bërë gjatë 12 muajve të parë të punës. Shtetet Anëtare duhet të caktojnë periudhat e matjeve ku do të vendosen vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike si edhe për ndotës të tjerë.
3. Koha e qëndrimit si edhe temperatura minimale, ashtu edhe përmbajtja e oksigjenit tek gazet e shkarkuara, duhet t'i nënshtrohen verifikimit të duhur, të paktën njëherë, kur impiantet e djegies dhe bashkëdjegies janë vënë në shërbim si edhe kur parashikohen kushte mjaft të pafavorshme pune.

4. Matja e vazhdueshme e HF mund të mënjanohet nëse përdoren fazat e trajtimit për HCl të cilat sigurojnë që vlera kufi e shkarkimit për HCl nuk është tejkaluar. Në këtë rast, shkarkimet e HCl duhet t'i nënshtrohen matjeve periodike të parashikuara në paragrafin 2 germa (c).

5. Matja e vazhdueshme e përbërjes së avujve të ujit nuk do të kërkohet nëse kampionët e gazeve të shkarkuara thahen para se të bëhet analizimi i shkarkimeve.

6. Matjet periodike të parashikuara në paragrafin 2 germa (c) të HCl, HF dhe SO₂, në vend të matjeve të vazhdueshme mund të autorizohen në lejen e dhënë nga autoriteti kompetent në impiantet e djegies dhe bashkëdjegies, nëse operatori mund të vërtetojë që shkarkimet e këtyre ndotësve në asnjë rrethanë nuk janë më të larta se vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara.

7. Pakësimi i frekuencës së matjeve periodike për metalet e rënda nga dy herë në vit në njëherë çdo dy vjet, dhe për dioksinat dhe furanet nga dy herë në vit në njëherë për çdo vit, mund të autorizohet tek leja e dhënë nga autoriteti kompetent, me kusht që shkarkimet që rezultojnë nga impiantet e djegies dhe bashkëdjegies të jenë poshtë nivelit 50% të vlerave kufi të shkarkimeve të vendosura përkatësisht sipas Shtojcës II apo Shtojcës V, dhe me kusht që të plotësohen kriteret për kërkesat, të zhvilluara në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 17. Këto kriteret duhet që të paktën të mbështeten tek dispozitat e nënparagrafit të dytë, germat (a) dhe (d).

Deri më datën 1 janar 2005, mund të autorizohet pakësimi i frekuencës edhe në rast se asnjëri prej këtyre kriterëve nuk është i disponueshëm, me kusht që:

- (a) mbetjet që do të digjen apo bashkëdigjen të përbëhen vetëm prej fraksionesh të caktuara të klasifikuara të djegshme të mbetjeve jo të rrezikshme, të cilat nuk janë të përshtatshme për riciklim, dhe që paraqesin karakteristika të caktuara, si edhe që përcaktohen më tej në bazë të vlerësimit të referuar në nënparagrafin (d);
- (b) kriteret kombëtare të cilësisë, të cilat i janë raportuar Komisionit, janë të disponueshme për këto mbetje;
- (c) bashkëdjegia dhe djegia e këtyre mbetjeve është në përputhje me planet përkatëse të administrimit të mbetjeve të referuara në nenin 7 të Direktivës 75/442/KEE;
- (d) operatori mund t'i vërtetojë autoritetit kompetent që në çdo rrethanë shkarkimet janë në mënyrë të konsiderueshme poshtë vlerave kufi të shkarkimeve të caktuara në Shtojcën II apo në Shtojcën V për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet, ky vlerësim duhet të mbështetet në informacionin për cilësinë e mbetjeve në fjalë si edhe matjet e shkarkimeve të këtyre ndotësve;
- (e) kriteret e cilësisë dhe periudha e re për matjet periodike të përcaktohen tek leja; dhe
- (f) të gjitha vendimet në lidhje me frekuencën e matjeve të referuara në këtë paragraf, të plotësuara me informacionin për sasinë dhe cilësinë e mbetjeve në fjalë, duhet t'i komunikohen Komisionit çdo vit.

8. Rezultatet e matjeve të bëra për të verifikuar përmbushjen (respektimin) e vlerave kufi të shkarkimeve duhet të standardizohen në bazë të kushteve të mëposhtme edhe për oksigjenin sipas formulës së referuar në Shtojcën VI:

- (a) Temperatura 273K, trysnia 101,3 kPa, 3% oksigjen, gaz i thatë, në gazin e shkarkuar të impianteve të djegies;
- (b) Temperatura 273K, trysnia 101,3 kPa, 3% oksigjen, gaz i thatë, në gazin e shkarkuar të djegies së vajit të mbetur ashtu siç parashikohet në Direktivën 75/442/KEE;
- (c) Kur mbetjet digjen apo bashkëdigjen në një atmosferë të pasuruar me oksigjen, rezultatet e matjeve mund të standardizohen në bazë të një përmbajtjeje oksigjeni të përcaktuar nga autoriteti kompetent duke pasqyruar rrethanat e veçanta të këtij rasti individual;
- (d) Në rastin e bashkëdjegies, rezultatet e matjeve mund të standardizohen në bazë të një përmbajtjeje totale të oksigjenit, ashtu siç përllogaritet në Shtojcën II.

Kur shkarkimet e ndotësve pakësohen nga trajtimi i gazeve të shkarkuara në një impiant djegieje apo bashkëdjegieje që merret me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, standardizimi në drejtim të përmbajtjes së oksigjenit të parashikuar në nënparagrafin e parë duhet të kryhet, vetëm, nëse përmbajtja e oksigjenit e matur gjatë së njëjtës periudhë si edhe për ndotësin në fjalë, e tejkalon përmbajtjen përkatëse standarde të oksigjenit.

9. Të gjitha rezultatet e matjeve duhet të regjistrohen, përpunohen dhe paraqiten në mënyrën e duhur, me qëllim që të mundësohet, që autoritetet kompetente të verifikojnë përmbushjen e kushteve të lejuara të punës, si edhe vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në këtë direktivë, në përputhje me procedurat që duhen vendosur nga autoritetet.

10. Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër duhet të konsiderohen si të respektuara vetëm nëse:

- (a) – asnjëra prej vlerave mesatare ditore nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën V germa (a) apo në Shtojcën II;
- (b) - 97% e vlerës mesatare ditore gjatë vitit nuk e tejkalon vlerën kufi të shkarkimit të përcaktuar në Shtojcën V germa (a), kryeradha e parë ;
- (c) - ose asnjëra prej vlerave mesatare gjysmëorëshe nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën V germa (b), kolona A, ose, atje ku ka lidhje, 97% e vlerave mesatare gjysmëorëshe gjatë vitit nuk i tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën V germa (b), kolona B;
- (d) - dispozitat e Shtojcës V germa (e), kryeradha e dytë apo Shtojca II, janë përmbushur.

11. Vlerat mesatare gjysmëorëshe dhe mesataret dhjetëminutëshe duhet të përcaktohen brenda kohës së efektshme të punës (duke përjashtuar periudhat e fillimit dhe mbylljes nëse nuk po digjet asnjë mbetje) nga vlerat e matura pasi është zbritur vlera e intervalit të besimit e përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës III. Vlerat mesatare ditore duhet të përcaktohen në bazë të vlerave mesatare të vlefshme.

Për të përfutur një vlerë të vlefshme mesatare ditore, jo më shumë se pesë mesatare ditore gjysmëorëshe, për çdo ditë duhet të mos merren parasysh si pasojë e keqfunksionimit apo mirëmbajtjes së sistemit të matjeve të vazhdueshme. Jo më shumë se dhjetë vlera mesatare ditore në vit duhet të mos merren parasysh si pasojë e keqfunksionimit apo mirëmbajtjes së sistemit të matjeve të vazhdueshme.

12. Vlerat mesatare përgjatë periudhës së kampionit si edhe vlerat mesatare në rastin e matjeve periodike të HF, HCl, dhe SO₂, duhet të përcaktohen në përputhje me kërkesat e nenit 10 pikat 2 dhe 4 dhe të Shtojcës III.

13. Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 17, duhet të vendosë, sapa masat e duhura teknike të jenë të disponueshme brenda Komunitetit, datën nga e cila matjet e vazhdueshme të vlerave kufi të shkarkimeve në ajër për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet do të kryhen në përputhje me Shtojcën III.

14. Matjet e mëposhtme duhet të kryhen në pikën e shkarkimit të ujërave të ndotura:

- (a) Matjet e vazhdueshme të parametrave të përmendura në nenin 8 pika 6 germa (b);
- (b) Mesataret ditore të kampionëve të marrë në vend të lëndëve të ngurta totale pezull; Shtetet Anëtare mund të sigurojnë matje të alternuara të një kampioni përfaqësues proporcional të rrjedhës gjatë një periudhe prej 24 orësh;
- (c) Të paktën matjet mujore të një kampioni përfaqësues proporcional të rrjedhës së shkarkimit gjatë një periudhe prej 24 orësh të substancave ndotëse, të referuara në nenin 8 pika 3, në drejtim të pikave 2 deri në pikën 10 të Shtojcës IV;
- (d) Të paktën çdo gjashtë muaj matjet e dioksinave dhe furaneve; sidoqoftë një matje të paktën çdo tre muaj duhet të kryhet për 12 muajt e parë të punës. Shtetet Anëtare mund të caktojnë periudhat e matjeve atje ku ato kanë vendosur vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike dhe ndotës të tjerë.

15. Vëzhgimi i masës së ndotësve në ujërat e ndotura të trajtuara duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin e Komunitetit dhe të përcaktohet në leje, ashtu si edhe frekuenca e matjeve.

16. Vlerat kufi të shkarkimeve për ujin duhet të konsiderohen si të përmbushura nëse:

- (a) Për lëndët e ngurta totale pezull (substancia ndotëse numër 1), 95% dhe 100% e vlerave të matura nuk i tejkalojnë vlerat përkatëse kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën IV;
- (b) Për metalet e rënda (substancat ndotëse numër 2-10) jo më shumë se një matje në vit i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën IV; ose, nëse Shteti Anëtar parashikon më shumë se 20 kampionë në vit, jo më shumë se 5% e këtyre kampionëve i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Shtojcën IV;
- (c) Për dioksinat dhe furanet (substancia ndotëse numër 11), matjet e bëra dy herë në vit nuk e tejkalojnë vlerën kufi të shkarkimit të përcaktuar në Shtojcën IV.

17. Nëse matjet e kryera tregojnë që vlerat kufi të shkarkimeve për ajrin dhe ujin, të parashikuara në këtë direktivë janë tejkaluar, autoritetet kompetente duhet të informohen pa vonesë.

Neni 12

E drejta për t'u njohur me informacionin dhe pjesëmarrja e publikut

1. Pa cenuar Direktivën e Këshillit 90/313/KEE [24] dhe Direktivën 96/61/KE, kërkesat për lejet e reja për impiantet e djegies dhe bashkëdjegies duhet të vendosen në dispozicion të publikut në një ose më shumë vende, që publiku të ketë të drejtë për t'u njohur me to, të tilla si zyrat e autoriteteve lokale, për një periudhë të mjaftueshme kohore, në mënyrë që ai të ketë mundësi të komentojë në lidhje me këto leje, para se autoriteti kompetent të marrë një vendim. Ai vendim, i cili duhet të përfshijë të paktën një kopje të lejes, si edhe përditësimet e mëpasshme, gjithashtu duhet të vihet në dispozicion të publikut.

2. Për impiantet e djegies dhe bashkëdjegies me një kapacitet nominal prej dy ose më shumë ton në orë, dhe pavarësisht nga neni 15 pika 2 i Direktivës 96/61/KE, raporti vjetor që i paraqitet autoritetit kompetent nga operatori në lidhje me funksionimin dhe vëzhgimin e impiantit, duhet t'i vihet në dispozicion edhe publikut. Raporti duhet që, si një kërkesë minimale, të japë llogari për ecurinë e procesit dhe shkarkimeve në ajër dhe ujë në krahasim me shkarkimet standarde të parashikuara në këtë direktivë. Një listë e impianteve të djegies dhe bashkëdjegies me një kapacitet nominal prej më pak se dy ton në orë duhet të hartohet nga autoriteti kompetent dhe duhet të vihet në dispozicion të publikut.

Neni 13

Kushtet jonormale të punës

1. Autoriteti kompetent duhet të përcaktojë në leje periudhën maksimale të lejueshme për ndalimet, shqetësimet apo defektet teknike të pashmangshme të pajisjeve të pastrimit apo atyre të matjes, gjatë të cilave përqendrimet e shkarkimeve në ajër dhe ujërat e ndotura të pastruara të substancave të rregulluara me ligj, mund të tejkalojnë vlerat kufi të caktuara.

2. Në rastin e një avarie, operatori duhet të pakësojë apo të mbyllë impiantin derisa mund të rifillojë operacionet normale të tij.

3. Pa cenuar nenin 6 pika 3 germa (c), impianti i djegies apo i bashkëdjegies, ose linja e djegies në asnjë lloj rrethane nuk duhet të vazhdojë të djegë mbetje për një periudhë kohore pa ndërprerje prej më shumë se katër orësh, në rast se janë tejkaluar vlerat kufi të shkarkimeve; për më tepër, kohëzgjatja e grumbulluar e operacioneve në këto kushte gjatë një viti duhet të jetë më e vogël se 60 orë. Kohëzgjatja prej 60 orësh zbatohet për ato linja të të gjithë impiantit, të cilat janë të lidhura me një pajisje pastruese të vetme të gazeve të oxhakat.

4. Përmbajtja totale e pluhurit të shkarkimeve në ajër e një impianti të djegies në asnjë lloj rrethane nuk duhet të tejkalojë 150 mg/m³ e shprehur si mesatare gjysmë-orëshe; për më tepër, vlerat kufi të shkarkimeve në ajër të CO dhe TOC nuk duhet të tejkalohen. Të gjitha kushtet e tjera të referuara në nenin 6 duhet të plotësohen.

Neni 14

Klauzola e rishikimit

Pa cenuar Direktivën 96/61/KE, Komisioni duhet t'i paraqesë një raport Parlamentit dhe Këshillit të Europës para datës 31 dhjetor 2008, duke u mbështetur në përvojën e zbatimit të kësaj direktive, në veçanti për impiantet e reja, si edhe në lidhje me progresin e arritur në drejtim të teknikave të kontrollit të shkarkimeve dhe përvojës së fituar në administrimin e mbetjeve. Më tej, raporti duhet të mbështetet në zhvillimin e gjendjes së teknologjisë, e përvojës së punës me impiantet, si edhe të kërkesave mjedisore. Ky raport duhet të përfshijë një seksion të caktuar për zbatimin e Shtojcës II. 1.1 dhe në veçanti për fizibilitetin ekonomik dhe teknik për furrat ekzistuese të çimentos, ashtu siç referohet në shënimin në fund të faqes tek Shtojca II. 1.1 në lidhje me respektimin e vlerës kufi të shkarkimeve të Nox për furrat e reja të çimentos, siç parashikohet në atë shtojcë. Raporti duhet që, atje ku është e përshtatshme, të shoqërohet nga propozimet për rishikim të dispozitave përkatëse të kësaj direktive. Sidoqoftë, Komisioni duhet, që nëse është e përshtatshme, të propozojë një ndryshim për Shtojcën II.3 para raportit në fjalë, nëse rrjedhat kryesore të mbetjeve i drejtohen llojeve të impianteve të bashkëdjegies dhe jo atyre që trajtohen në Shtojcën II.1 dhe II.2.

Neni 15 **Raportimi**

Raportet për zbatimin e kësaj direktive duhet të hartohen në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 5 të Direktivës së Këshillit 91/692/KEE. Raporti i parë duhet të mbulojë të paktën periudhën e parë tre-vjeçare pas datës 28 dhjetor 2002 dhe të përmbushë periudhat e referuara në nenin 17 të Direktivës 94/67/KE dhe në nenin 16 pika 3 të Direktivës 96/61/KE. Për këtë qëllim, Komisioni duhet të hartojë pyetësin e përshtatshëm në kohën e duhur.

Neni 16 **Përshtatja e direktivës në të ardhmen**

Komisioni duhet që, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 17 pika 2, të ndryshojë nenet 10, 11 dhe 13 si edhe Shtojcat I dhe III, me qëllim që t'i përshtatë ato me progresin teknik dhe konstatimet e reja që kanë të bëjnë me përfitimet shëndetësore nga pakësimi i shkarkimeve.

Neni 17 **Komiteti rregullator**

1. Komisioni duhet të mbështetet nga një komitet rregullator.
2. Aty ku ka referenca ndaj këtij paragrafi, do të zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh edhe dispozitat e nenit 8 të tij.
Periudha e parashikuar në nenin 5 pika 6 të Vendimit 1999/468/KE, duhet të caktohet në tre muaj.
3. Komiteti duhet të miratojë rregullat e veta procedurale.

Neni 18 **Shfuqizimi**

Duke filluar nga data 28 dhjetor 2005, do të shfuqizohen si më poshtë vijon:

Neni 8 pika 1 dhe Shtojca e Direktivës 75/439/KEE;
Direktiva 89/369/KEE;
Direktiva 89/429/KEE;
Direktiva 94/67/KE.

Neni 19 **Sanksionet**

Shtetet Anëtare përcaktojnë sanksione të zbatueshme për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara në mbështetje të kësaj direktive. Sanksionet e siguruara në këtë mënyrë duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe parandaluese. Shtetet Anëtare duhet t'ia bëjnë të ditura Komisionit këto dispozita jo më vonë se data 28

dhjetor 2002, dhe duhet të njoftojnë Komisionin pa vonesë në lidhje me çdo ndryshim që mund t'u bëhet atyre dispozitave.

Neni 20 **Dispozitat kalimtare**

1. Pa cenuar dispozitat kalimtare të caktuara të parashikuara në shtojcat e kësaj direktive, dispozitat e kësaj direktive do të zbatohen për impiantet ekzistuese duke filluar nga data 28 dhjetor 2005.
2. Për impiantet e reja, d.m.th. për impiantet që nuk përfshihen në përkufizimin e “impianteve ekzistuese të djegies dhe bashkëdjegies” në nenin 3 pika 6 apo të paragrafit 3 të këtij neni, kjo direktivë, në vend të direktivës së përmendur në nenin 18, do të zbatohet duke filluar nga data 28 dhjetor 2002.
3. Impiantet e palëvizshme apo të lëvizshme, qëllimi i të cilave është prodhimi i energjisë apo produkteve të materialeve, të cilat janë në punë dhe kanë një leje në përputhje me legjislacionin ekzistues të Komunitetit atje ku kërkohet dhe që fillojnë bashkëdjegien e mbetjeve jo më vonë se data 28 dhjetor 2004, duhet të konsiderohen si impiante ekzistuese të bashkëdjegies.

Neni 21 **Zbatimi**

1. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për përmbushjen e kësaj direktive, jo më vonë se data 28 dhjetor 2002. Ato duhet më tej, të njoftojnë Komisionin në lidhje me to.
Kur Shtetet Anëtare t'i miratojnë këto dispozita, ato duhet të përmbajnë një referencë ndaj kësaj direktive, ose duhet të shoqërohen nga një referencë e tillë në rastin e botimit të tyre zyrtar. Metodatat e bërjes së një reference të tillë do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.
2. Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin Komisionit tekstin e dispozitave të legjislacionit kombëtar që ato do të miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë.

Neni 22 **Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë do të hyjë në fuqi ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 23 **Adresa**

Kjo direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 4 dhjetor 2000.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

N.Fontaine

Për Këshillin

Presidenti

F.Vedrine

[1] GZ C 13, 17.01.1998, fq.6 dhe GZ 372, 02.12.1998, fq. 11.

[2] GZ C 116, 28.04.1999, fq. 40.

- [3] GZ C 198, 14.07.1999, fq.37.
- [4] Opinioni i Parlamentit Europian, datë 14 prill 1999 (GZ C219, 30.7.1999, fq.249), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 25 nëntor 1999 (GZ C 25, 28.1.2000, fq.17) dhe Vendimi i Parlamentit Europian, datë 15 mars 2000 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Parlamentit Europian, datë 16 nëntor 2000 dhe Vendimi i Këshillit, datë 20 nëntor 2000.
- [5] GZ C 138, 17.05.1993, fq.1 dhe GZ C 275, 10.10.1998, fq. 1.
- [6] GZ C 76, 11.03.1997, fq.1.
- [7] GZ L 257, 10.10.1996, fq. 26.
- [8] GZ L 163, 14.06.1989, fq. 32. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [9] GZ L 203, 15.07.1989, fq. 50. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [10] GZ L 163, 29.06.1999, fq. 41.
- [11] GZ L 365, 31.12.1994, fq. 34.
- [12] GZ L 194, 25.07.1975, fq. 39. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Vendimi i Komisionit 350/96/KE (GZ L 135, 6.6.1996, fq. 32).
- [13] Direktiva e Këshillit 90/667/KEE, datë 27 nëntor 1990, ku përcaktohen rregullat veterinarë për asgjësimin dhe përpunimin e mbetjeve me origjinë shtazore, për hedhjen e tyre në treg si edhe për parandalimin e patogjeneve në ushqimet e kafshëve me origjinë shtazore apo nga peshqit, gjithashtu edhe ndryshimi i Direktivës 90/425/ KEE (GZ L 363, 27.12.1990, fq. 51). Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [14] Direktiva e Këshillit 91/272/KEE, datë 21 maj 1991, për trajtimin e ujërave të zeza urbane (FZ L135, 30.05.1991, fq.40). Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 98/15/KE (GZ L 67, 07.03.1998, fq. 29).
- [15] Direktiva e Këshillit 96/62/ KE, datë 27 shtator 1996, për vlerësimin dhe administrimin e cilësisë së ajrit të mjedisit (GZ L 296, 21.11.1996, fq.5).
- [16] Direktiva e Këshillit 76/464/KEE, datë 4 maj 1976, për ndotjen e shkaktuar nga disa substanca të rrezikshme të shkarkuara në mjedisin ujor të Komunitetit (GZ L 129, 18.05.1976, fq. 23). Direktiva e ndryshuar nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [17] Direktiva 1999/31/KE, datë 26 prill 1999, për landfillet e mbetjeve (GZ L 182, 16.07.1999, fq. 1).
- [18] GZ L 184, 17.07.1999, fq. 23.
- [19] GZ L 377, 31.12.1991, fq. 20. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 94/31/KE. (GZ L 168, 02.07.1994, fq. 28).
- [20] GZ L 194, 25.07.1975, fq. 23. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [21] GZ L 194, 25.07.1975, fq. 23. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [22] Direktiva e Këshillit 93/12/KEE, datë 23 mars 1993, në lidhje me përmbajtjen e squfurit të disa lëndëve djegëse të lëngshme (GZ L 74, 27.03.1993, fq. 81). Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva 1999/32/KE (GZ L 121, 11.05.1999, fq. 13).
- [23] Vendimi i Këshillit 94/3/KE, datë 20 dhjetor 1993, që harton një listë mbetjesh sipas nenit 1 germa (a) të Direktivës së Këshillit 75/442/KEE për mbetjet (GZ L 5, 7.1.1994, fq. 15)
- [24] GZ L 30, 06.02.1993, fq.1. Rregullore e ndryshuar së fundi nga Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2408/98 (GZ L 298, 07.11.1998, fq.10).
- [25] Direktiva e Këshillit 90/313/KEE, datë 7 qershor 1990, për lirinë e aksesit në informacionin për mjedisin (GZ L 158, 23.6.1990, fq. 56), Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.

SHTOJCA I

Faktorët e barasvlefshmërisë për dibenzo-p-dioksinat dhe dibenzofuranet

Për përcaktimin e përqendrimit total (TE) të dioksinave dhe furaneve, përqendrimet e masës së dibenzo-p-dioksinave dhe dibenzofuraneve të mëposhtme duhet të shumëzohen me faktorët e mëposhtëm të barasvlefshmërisë para mbledhjes së tyre:

Faktori i barasvlefshmërisë toksike

2,3,7,8	-Tetraklorurdibenzodioksinë(TCDD)	1
1,2,3,7,8	-Pentaklorurdibenzodioksinë(PeCDD)	0,5
1,2,3,4,7,8	-Hekzaklorurdibenzodioksinë(HxCDD)	0,1
1,2,3,6,7,8	-Hekzaklorurdibenzodioksinë(HxCDD)	0,1
1,2,3,7,8,9	-Hekzaklorurdibenzodioksinë(HxCDD)	0,1
1,2,3,4,6,7,8	- Heptaklorurdibenzodioksinë(HpCDD)	0,01
	- Oktaklorurdibenzodioksinë(OCDD)	0,001
2,3,7,8	-Tetraklorurdibenzofuran (TCDF)	0,1
2,3,4,7,8	- Pentaklorurdibenzofuran (PeCDF)	0,5
1,2,3,7,8	- Tetraklorurdibenzofuran (TCDF)	0,05
1,2,3,4,7,8	- Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,6,7,8	- Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,7,8,9	- Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
2,3,4,6,7,8	- Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,4,6,7,8	- Heptaklorurdibenzofuran (HpCDF)	0,01
1,2,3,4,7,8,9	- Heptaklorurdibenzofuran (HpCDF)	0,01

SHTOJCA II

Përcaktimi i vlerave kufi të shkarkimeve në ajër për bashkëdjegien e mbetjeve

Formula e mëposhtme (rregulli i përzierjes) duhet të zbatohet sa herë që një vlerë kufi shkarkimi totale e caktuar "C" nuk është përcaktuar në një tabelë të kësaj shtojce.

Vlera kufi për çdo ndotës përkatës dhe monoksid karboni në gazet e shkarkuara që rezulton nga bashkëdjegia e mbetjeve do të llogaritet si më poshtë vijon:

$$\frac{V_{\text{mbetjeve}} \times C_{\text{mbetjeve}} + V_{\text{proc}} \times C_{\text{proc}}}{V_{\text{mbetjeve}} + V_{\text{proc}}} = C$$

Vmbetjeve: Vëllimi i gazeve të shkarkuara që rezultojnë nga djegia e mbetjeve i përcaktuar vetëm nga mbetjet me vlerën më të ulët kalorifike të përcaktuar në leje dhe të standardizuara në kushtet e dhëna nga kjo direktivë.

Nëse çlirimi i nxehtësisë që rezulton nga djegia e mbetjeve të rrezikshme shkon në më pak se 10% e sasisë totale të nxehtësisë së çliruar në impiant, Vmbetjeve duhet të llogaritet nga sasia (nominale) e mbetjeve që, kur të digjen, do të ishin të barabarta me 10% të çlirimit të nxehtësisë, me çlirimin total të nxehtësisë së përcaktuar.

Cmbetjeve: Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara për impiantet e djegies në Shtojcën V për ndotësit përkatës dhe monoksidin e karbonit.

Vproc: Vëllimi i gazeve të shkarkuara që rezultojnë nga procesi i impiantit duke përfshirë edhe djegien e lëndëve djegëse të autorizuara, që përdoren normalisht në impiante (duke përjashtuar mbetjet), të përcaktuara në bazë të përmbajtjes me oksigjen në të cilën duhet të standardizohen shkarkimet, siç parashikohet në rregulloret e Komunitetit apo ato kombëtare. Në mungesë të rregulloreve për këto lloj impiantesh, përmbajtja e vërtetë e oksigjenit në gazet e oxhakut pa u holluar nga shtimi i panevojshëm i ajrit duhet përdorur për këtë proces. Standardizimi në kushte të tjera jepet në këtë direktivë.

Cproc: Vlerat kufi të shkarkimeve siç përcaktohen në tabelat e kësaj shtojce për disa sektorë industrialë ose në rastin e mungesës së një tabelle të tillë ose të vlerave të tilla, vlerat kufi të shkarkimeve të ndotësve përkatës dhe monoksidit të karbonit në gazet e oxhakut të impianteve të cilat përmbushin ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative kombëtare për impiante të tilla, ndërkohë që djegin lëndët djegëse të autorizuara normalisht (duke përjashtuar mbetjet). Në mungesë të këtyre vlerave të lejes, do të përdoren përqendrimet e vërteta të masës.

C: Vlerat kufi të shkarkimeve totale dhe përmbajtja e oksigjenit, ashtu siç përcaktohet në tabelat e kësaj shtojce, për disa sektorë industrialë dhe ndotës të caktuar apo në rastin e mungesës së një tabelle apo vlerave të tilla totale kufi të shkarkimeve për CO dhe ndotësit përkatës, që zëvendësojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në shtojcat e caktuara të kësaj direktive. Përmbajtja totale e oksigjenit që do të zëvendësojë përmbajtjen e oksigjenit për standardizimin e tyre llogaritet në bazë të përmbajtjes së mësipërme duke respektuar vëllimet e pjesshme.

Shtetet Anëtare mund të hartojnë rregulla për qeverisjen e përjashtimeve të parashikuara në këtë shtojcë.

II.1. Dispozita të veçanta për furrat e çimentos të cilat bashkëdjegin mbetjet

Vlerat mesatare ditore (për matjet e vazhdueshme). Periudhat e kampionëve dhe kërkesa të tjera të matjeve si në nenin 7. Të gjitha vlerat në mg/m³ (dioksinat dhe furanet në ng/m³). Vlerat mesatarë gjysmë-orëshe do të nevojiten vetëm për qëllimin e përlogaritjes së vlerave ditore mesatare.

Rezultatet e matjeve të bëra për të verifikuar përmbushjen e vlerave kufi të shkarkimeve duhet të standardizohen sipas kushteve të mëposhtme: Temperatura 273 K, trysnia 101,3 kPa, 10% oksigjen, gaz i thatë.

II.1.1. C- vlerat kufi të shkarkimeve totale

Ndotësi	C
Pluhuri total	30
HCl	10
HF	1
NO _x për impiantet ekzistuese	800
NO _x për impiantet e reja	500(1)
Cd +Tl	0,05
Hg	0,05
Sb+As+Pb+Cr+Co+Cu+Mn+Ni+V	0,5
Dioksinat dhe furanet	0,1

(1) Për zbatimin e vlerave kufi të shkarkimeve të NO_x, furrat e çimentos të cilat janë në punë dhe kanë një leje në përputhje me legjislacionin ekzistues të Komunitetit dhe të cilat fillojnë të bashkëdjegin mbetje pas datës së përmendur në nenin 20 pika 3 nuk duhet të konsiderohen si impiante të reja.

Deri më 1 janar 2008, përjashtimet për NO_x mund të autorizohen nga autoritetet kompetente për furrat e çimentos ekzistuese me proces të lagët, apo furrat e çimentos të cilat djegin më pak se tre ton mbetjesh në orë, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total për NO_x prej jo më shumë se 1200 mg/m³.

Deri më 1 janar 2008, përjashtimet për pluhurin mund të autorizohen nga autoritetet kompetente për furrat e çimentos të cilat djegin më pak se tre ton mbetjesh në orë, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total prej jo më shumë se 50 mg/m³.

II.1.2. C- vlerat kufi të shkarkimeve totale për SO₂, dhe TOC.

Ndotësi	C
SO ₂	50
TOC	10

Përjashtimet mund të autorizohen nga autoriteti kompetent në rastet kur TOC dhe SO₂ nuk rezultojnë nga djegia e mbetjeve.

II.1.3. Vlera kufi e shkarkimit për CO

Vlerat kufi të shkarkimeve për CO mund të caktohen nga autoriteti kompetent.

II.2. Dispozitat e veçanta për impiantet e djegies të cilat bashkëdjegin mbetje

II.2.1 Vlerat mesatare ditore

Pa cenuar Direktivën 88/609/KEE dhe në rastet kur, për impiante të mëdha djegieje, janë caktuar vlera kufi më rigorozë për shkarkimet sipas legjislacionit të ardhshëm të Komunitetit, këto të fundit do të zëvendësojnë, për impiantet dhe ndotësit në fjalë, vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në tabelat e mëposhtme (Cproc). Në

atë rast, tabelat e mëposhtme do të përshtaten pa vonesë me këto vlera kufi më rigorozë të shkarkimeve, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 17 .

Vlerat mesatare gjysmëorëshe do të nevojiten vetëm për qëllimin e përlogaritjes së vlerave mesatare ditore.

Cproc:

Cproc për lëndët djegëse të ngurta e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%).

Ndotësit	<50 MWth	50-100 MWth	100-300 MWth	>300 MWth
SO ₂ Rasti i përgjithshëm Lëndët djegëse të origjinës		850 Ose norma e desulfurizimit ≥90%	850-200 (rënie lineare nga 100-300 MWth) Ose norma e desulfurizimit ≥92%	200 Ose norma e desulfurizimit ≥95%
NO _x		400	300	200
Pluhuri	50	50	30	30

Deri më 1 janar 2007, dhe pa cenuar legjislacionin përkatës të Komunitetit, vlerat kufi të shkarkimeve për NO_x nuk do të zbatohen për impiantet të cilat bashkëdjegin vetëm mbetje të rrezikshme.

Deri më 1 janar 2007, përjashtimet për NO_x dhe SO₂ mund të autorizohen nga autoritetet kompetente për impiantet ekzistuese të bashkëdjegies ndërmjet 100 dhe 300 MWth, të cilat përdorin teknologjinë me shtrat të lëngët dhe djegien e lëndëve djegëse të ngurta, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total (Cproc) prej jo më shumë se 350 mg/Nm³ për NO_x dhe jo më shumë se 850-400 mg/Nm³ (rritja lineare nga 100-300 MWth) për SO₂.

Cproc për biomasën e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%):

Biomasë do të thotë: produktet që përbëhen nga e gjithë lënda e perimeve apo një pjesë e saj nga bujqësia ose pyjet, që mund të përdoret për qëllimin e rikuperimit të përbërjes së saj energjetike si edhe mbetjet e renditura në nenin 2 pika 2 germa (a) nënpikat (i) deri (v).

Ndotësit	<50 Mth	50-100 MWth	100-300 MWth	>300 MWth
SO ₂		200	200	200
NO _x		350	300	300
Pluhuri	50	50	30	30

Deri më 1 janar 2008, përjashtimet për NO_x mund të autorizohen nga autoritetet kompetente për impiantet ekzistuese të bashkëdjegies ndërmjet 100 dhe 300 MWth, të cilat përdorin teknologjinë me shtrat të lëngët dhe djegien e biomasës, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total (Cproc) prej jo më shumë se 350 mg/Nm³.

Cproc për lëndët djegëse të lëngshme e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 3%).

Ndotësit	<50 MWth	50-100 MWth	100-300 MWth	>300 MWth
SO ₂		850	850-200 (rritje lineare nga 100-300 MWth)	200

NO _x		400	300	200
Pluhuri	50	50	30	30

II.2.2. C-vlerat kufi të shkarkimeve totale

C e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së kampionëve prej një minimumi 30 minutash dhe një maksimumi 8 orësh:

Ndotësi	C
Cd +Tl	0,05
Hg	0,05
Sb+As+Pb+Cr+Co+Cu+Mn+Ni+V	0,5

C e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së kampionëve prej një minimumi 6 orësh dhe një maksimumi 8 orësh:

Ndotësi	C
Dioksinat dhe furanet	0,1

II.3. Dispozitat e veçanta për sektorët e industrisë që nuk mbulohen nga II.1. apo II.2. për bashkëdjegien e mbetjeve

II.3.1. C-vlerat kufi të shkarkimeve totale

C e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së kampionëve prej një minimumi 6 orësh dhe një maksimumi 8 orësh:

Ndotësi	C
Dioksinat dhe furanet	0,1

C e shprehur në mg/Nm³ (përmbajtja e O₂ 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së kampionëve prej një minimumi 30 minutash dhe një maksimumi 8 orësh:

Ndotësi	C
Cd +Tl	0,05
Hg	0,05

SHTOJCA III Teknikat e matjes

- Matjet për përcaktimin e përqendrimeve të substancave ndotëse në ajër dhe ujë duhen të kryhen në mënyrë përfaqësuese.
- Marrja e kampionëve dhe analizimi i të gjithë ndotësve, që përfshijnë dioksinat dhe furanet, si edhe metodat e matjeve të referencës për të kalibruar sistemet e automatizuara të matjes, do të kryhen sipas standardeve të dhëna CEN. Nëse standardet CEN nuk janë të disponueshme, do të zbatohen standardet ISO, standardet kombëtare apo ndërkombëtare, të cilat do të sigurojnë marrjen e të dhënave të një cilësie shkencore të barasvlefshme.
- Në nivelin e vlerës kufi të shkarkimeve ditore, vlerat prej 95% të intervaleve të besimit të një rezultati të vetëm të matur nuk duhet të tejkalojnë përqindjet e mëposhtme të vlerave kufi të shkarkimeve:

Monoksidi i karbonit: 10%
Dioksidi i squfurit: 20%

Dioksidi i azotit:	20%
Pluhuri total:	30%
Karboni organik total:	30%
Kloruri i hidrogjenit:	40%
Fluoruri i hidrogjenit	40%

SHTOJCA IV

Vlerat kufi të shkarkimeve për shkarkimet e ujërave të ndotura nga pastrimi i gazeve të shkarkuara

Substancat ndotëse	Vlerat kufi të shkarkimeve të shprehura në përqendrim të masës për kampionët e pafiltruar	
1. Lëndët e ngurta totale pezull siç përkufizohen nga Direktiva 91/271/EEC	95% 30mg/l	100% 45mg/l
2. Mercuri dhe përbërjet e tij, të shprehura si merkur (Hg)	0,03 mg/l	
3. Kadmiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si kadmium(Cd)	0,05 mg/l	
4. Taliumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si talium (Tl)	0,05 mg/l	
5. Arseniku dhe përbërjet e tij, të shprehura si arsenik (As)	0,15 mg/l	
6. Plumbi dhe përbërjet e tij, të shprehura si plumb (Pb)	0,2 mg/l	
7. Kromi dhe përbërjet e tij, të shprehura si krom (Cr)	0,5 mg/l	
8. Bakri dhe përbërjet e tij, të shprehura si bakër (Cu)	0,5 mg/l	
9. Nikeli dhe përbërjet e tij, të shprehura si nikel (Ni)	0,5 mg/l	
10. Zinku dhe përbërjet e tij, të shprehura si zink (Zn)	1,5 mg/l	
11. Dioksinat dhe furanet, të përkufizuara si shuma e dioksinave dhe furaneve individuale të vlerësuara në përputhje me Shtojcën 1	0,3 mg/l	

Deri më 1 janar 2008, përjashtimet për lëndët e ngurta totale pezull mund të autorizohen nga autoriteti kompetent për impiantet ekzistuese të djegies me kusht që leja të parashikojë që 80% e vlerave të matura të mos e tejkalojë 30mg/l dhe asnjë prej tyre të mos e tejkalojë vlerën prej 45mg/l.

SHTOJCA V

Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër

(a) Vlerat mesatare ditore

Pluhuri total	10 mg/m ³
Substancat e gazta dhe të avullta, të shprehura si karbon organik total	10 mg/m ³
Kloruri i hidrogjenit (HCl)	10 mg/m ³
Fluoruri i hidrogjenit (HF)	1 mg/m ³
Dioksidi i squfurit (SO ₂)	50 mg/m ³

Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO ₂) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të djegies me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 ton në orë ose impiante të reja djegieje	200 mg/m ³ (*)
Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO ₂) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të djegies me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 ton në orë ose më pak	400 mg/m ³

(*) Deri më 1 janar 2007 dhe pa cenuar legjislacionin përkatës të Komunitetit, vlera kufi e shkarkimit për NO_x nuk do të zbatohet për impiantet të cilat djegin vetëm mbetje të rrezikshme.

Përfshirjet për NO_x mund të autorizohen nga autoriteti kompetent për impiantet ekzistuese të djegies:

- me një kapacitet nominal prej 6 ton në orë, me kusht që leja të parashikojë vlerat mesatare ditore të cilat nuk i tejkalojnë 500mg/m³ dhe kjo deri më 1 janar 2008,
- me një kapacitet nominal prej >6 ton në orë, por të barabartë apo më të vogël se 16 ton në orë, me kusht që leja të parashikojë vlerat mesatare ditore të cilat nuk i tejkalojnë 400mg/m³ dhe kjo deri më 1 janar 2010,
- me një kapacitet nominal prej >16 ton në orë, por <25 ton në orë dhe që nuk prodhojnë shkarkime uji, me kusht që leja të parashikojë vlerat mesatare ditore të cilat nuk i tejkalojnë 400mg/m³ dhe kjo deri më 1 janar 2008.

Deri më 1 janar 2008, përjashtimet për pluhurin mund të autorizohen nga autoriteti kompetent për impiantet ekzistuese të djegies me kusht që leja të parashikojë që vlerat mesatare ditore të mos i tejkalojnë 20mg/m³.

(b) Vlerat mesatare gjysmëorëshe

	(100%) A	(97%) B
Pluhuri total	30mg/m ³	10mg/m ³
Substancat e gazta dhe të avullta, të shprehura si karbon organik total	20mg/m ³	10mg/m ³
Kloruri i hidrogjenit (HCl)	60mg/m ³	10mg/m ³
Fluoruri i hidrogjenit (HF)	4mg/m ³	2 mg/m ³
Dioksidi i squfurit (SO ₂)	200mg/m ³	50mg/m ³
Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO ₂) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të djegies me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 ton në orë ose impiante të reja djegieje	400mg/m ³ (*)	200mg/m ³ (*)

(*) Deri më 1 janar 2007 dhe pa cenuar legjislacionin përkatës të Komunitetit, vlera kufi e shkarkimit për NO_x nuk do të zbatohet për impiantet të cilat djegin vetëm mbetje të rrezikshme.

Deri më 1 janar 2010, përjashtimet për NO_x mund të autorizohen nga autoriteti kompetent për impiantet ekzistuese të djegies me një kapacitet nominal ndërmjet 6 dhe 16 ton në orë, me kusht që vlerat mesatare gjysmëorëshe të mos i tejkalojnë 600mg/m³ për kolonën A ose 400 mg/m³ për kolonën B.

(c) Të gjitha vlerat mesatare përgjatë periudhës së kampionit të një minimumi prej 30 minutash dhe një maksimumi prej 8 orësh

	Totali 0,05 mg/m ³	Totali 0,1 mg/m ³ (*)
Kadmiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si kadmium (Cd)		
Taliumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si		

talium (Tl)		
Merkuri dhe përbërjet e tij, të shprehura si merkur (Hg)	0,05 mg/m ³	0,1 mg/m ³ (*)
Antimoni dhe përbërjet e tij, të shprehura si antimon (Sb)	Totali 0,5 mg/m ³	Totali 1 mg/m ³ (*)
Arseniku dhe përbërjet e tij, të shprehura si arsenik (As)		
Plumbi dhe përbërjet e tij, të shprehura si plumb (Pb)		
Kromi dhe përbërjet e tij, të shprehura si krom (Cr)		
Kobalti dhe përbërjet e tij, të shprehura si kobalt (Co)		
Bakri dhe përbërjet e tij, të shprehura si bakër (Cu)		
Mangani dhe përbërjet e tij, të shprehura si mangan (Mn)		
Nikeli dhe përbërjet e tij, të shprehura si nikel (Ni)		
Vanadiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si vanadium (V)		

(*) Deri më 1 janar 2007 vlerat mesatare për impiantet ekzistuese për të cilat leja e punës është dhënë para datës 31 dhjetor 1996, dhe të cilat djejin vetëm mbetje të rrezikshme.

Këto vlera mesatare mbulojnë gjithashtu format e gazta dhe të avullta të shkarkimeve përkatëse të metaleve të rënda si edhe përbërjet e tyre.

(d) Vlerat mesatare duhet të maten përgjatë periudhës së kampionit të një minimumi prej 6 orësh dhe një maksimumi prej 8 orësh. Vlera kufi e shkarkimit i referohet përqendrimit total të dioksinave dhe furaneve të llogaritur duke përdorur konceptin e barasvlefshmërisë toksike në përputhje me Shtojcën 1.

Dioksinat dhe furanet	0,1 ng/m ³
-----------------------	-----------------------

(e) Vlerat kufi të shkarkimeve të mëposhtme të përqendrimeve të monoksidit të karbonit (CO) nuk duhet të tejkalohen në gazet e djegies (duke përfshirë fazën e fillimit dhe atë të mbylljes):

- 50 miligramë/m³ të gazit të djegies e përcaktuar si vlera mesatare ditore;
- 150 miligramë /m³ të gazit të djegies e të paktën 95% të matjeve të përcaktuara si vlerat mesatare gjysmë-orëshe të marra gjatë çdo periudhe 24 orëshe.

Përfshirjet mund të autorizohen nga autoriteti kompetent për impiantet e djegies që përdorin teknologjinë me shtrat të lëngshëm, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi për monoksidin e karbonit (CO) prej jo më shumë se 100mg/m³ si vlerë mesatare në orë.

(f) Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë rregulla që rregullojnë përjashtimet e parashikuara në këtë shtojcë.

SHTOJCA VI

Formula për llogaritjen e përqendrimit të shkarkimit në përqendrimin standard të përqindjes të oksigjenit

$$E_s = \frac{21 - OS}{21 - OM} \times XEM$$

ES = përqendrimi i shkarkimit të përlogaritur në përqendrime standarde të përqindjes së oksigjenit

EM = përqendrimi i matur i shkarkimit

OS= përqendrimi standard i oksigjenit

OM= përqendrimi i matur i oksigjenit